



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
KËSHILLI BASHKIAK BERAT
Komisioni i Përhershëm për Ekonominë, Financën dhe Shërbimet Sociale

RAPORT VENDIMMARRJE

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: “MBI PËRDORIMIN E FONDIT TË SHËRBIMIT SOCIAL, MBËSHTETJE FINANCIARE NË RASTE FATKEQËSIE PËR TË NDJERIN Z.GANI HODO

”

Analiza ligjore: (bazueshmëria ligjore)

Propozimi mbështetet në ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M-së nr. 597 , datë 04.09.2019, e ndryshuar, datë 29.12.2021, “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” VKB-së nr.3, datë 27.01.2025 “Për miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok - ndihmën ekonomike deri në 6% dhe nga fondet e drejtorisë së Shërbimit Social”, VKB-së nr.108, datë 18.12.2024 “Per miratimin e buxhetit te vitit 2025 dhe PBA përfundimtare 2025-2027”, ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 4 pika 4, ligjin nr.121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, vendim nr. 518, datë 03.10.2018 “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”, ligjin nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”

Situata aktuale e funksionit(përshkrim i situatës së shërbimit / funksionit)

I ndjeri z. Gani Hodo, ka jetuar në lagjen “Kushtrim” ku prej 12 vitesh ku ka qënë i diagnostikuar si para-tetraplegjik pas një tensioni të lartë dhe me statusin e invalidit të plotë të punës. Familja, përbëhet nga dy anëtarë dhe jeton në kushte shumë të vështira ekonomike ku të ardhurat mujore janë të pamjaftueshme. Burimi i të ardhurës së vetme që ka familja është pension minimal i



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

znj.Hodo që mezi mbulojnë nevojat bazë të jetesës si ushqimi, energjia elektrike, medikamentete dhe shpenzimet e tjera familjare.

Në bazë të verifikimeve dhe informacionit të administruar pranë familjes, rezulton se gjendja social-ekonomike e kësaj familje është e vështirë dhe të ardhurat mujore janë të pamjaftueshme për të përballuar shpenzimet e ceremonise mortore dhe varrimit.

Ku vdekja e të ndjerit ka rënduar më tej gjendjen ekonomike dhe sociale të familjes, duke e bërë të pamundur sigurimin e të gjitha shërbimeve të nevojshme funerale pa mbështetje financiare.

Gjatë vizitave në familje, nga strukturat e shërbimit social, është vlerësuar situatë e vështirë e jetesës që familja ka dhe pamundësia ekonomike.

Situata financiare :

Duke u bazuar në historikun, problematikat e rastit dhe vlerësimin social nga strukturat e shërbimit social, pamundësive financiare për të përballuar shpenzimet e varrimit, kërkesës së paraqitur nga *znj.Xulieta Hodo* drejtorja e Shërbimit Social, propozon të përballoj shpenzimet e varrimit, në shumën 46.000 (dyzet e gjashtë mijë) lekë.

Drejtorja / Sektori përgjegjës

Drejtorja e Financës dhe Drejtorja e Shërbimit Social.

A është objekt i konsultimit publik:

Jo.Nuk është objekt konsultimi

Komisioni i Përhershëm për “ **Ekonominë,Financën dhe Shërbimet Sociale**”, i mbledhur në datën 28 /05/2026, shqyrtoi projekt vendimin “**MBI PËRDORIMIN E FONDIT TË SHËRBIMIT SOCIAL, MBËSHTETJE FINANCIARE NË RASTE FATKEQËSIE PËR TË NDJERIN Z.GANI HODO**”



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,

Komisioni me shumicë votash

VENDOSI:

1. Miratimin e dhënies së ndihmës financiare të menjëhershme për përballimin e shpenzimeve në raste fatkeqësie, për të ndjerin Z.Gani Hodo në shumën 46.000 (pesëdhjetë mijë) lekë.
2. Shuma prej 46.000 (dyzet e gjashtë mijë) lekë, do të përballohet nga buxheti i Drejtorisë së Shërbimit Social për vitin 2026.
3. Pagesa do të bëhet për llogari të znj. Xhulieta Hodo bashkëshortia e të ndjerit.

Komisioni i Përhershëm për Ekonominë,Financën dhe Shërbimet Sociale

Krenar Suku- Kryetar i Komisionit

Anisa Veliu –N/Kryetar

Endrina Tangu-Sekretar i Komisionit

Fatjon Elezi-Anëtar

Rovena Cuku-Anëtar

Muharem Hoxha-Anëtar

Shyqyri Dura-Anëtar

Datë 28 /05/2026